

Udhëzuesi për aplikim
Fondi për përkrahje emergjente të shoqërisë civile

Përmbajtja

1. Për fondin.....	1
2. Çfarë ofron fondi.....	2
3. Kriteret dhe Kualifikueshmëria.....	3
4. Procedura e aplikimit.....	7
5. Si bëhet vlerësimi.....	9
6. Shtojca I – Vlerat themelore.....	11
7. Shtojca II – Deklarata mbi Personat e ekspozuar politikisht...	13

1. Për fondin

Fondi për Përkrahje Emergjente të Shoqërisë Civile është një mekanizëm rajonal i reagimit të shpejtë, i themeluar për të mbështetur akterët e shoqërisë civile që përballen me presione urgjente ose të përshkallëzuara, të cilat rrezikojnë sigurinë e tyre, veprimtarinë që zhvillojnë, apo aftësinë për të ushtruar funksionin e tyre në shërbim të interesit publik. Fondi operon si një mekanizëm grantesh me karakter emergjent dhe mbrojtës, i dizajnuar për t'iu përgjigjur rreziqeve të menjëhershme, dhe nuk ka për qëllim mbështetjen e aktiviteteve programore afatgjata.

Në Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë, Kroaci, Kosovë, Mal të Zi, Maqedoni të Veriut dhe Serbi, organizatat e shoqërisë civile, iniciativat joformale, mediat e pavarura jofitimprurëse dhe aktivistët individualë janë gjithnjë e më të ekspozuar ndaj kërcënimeve ligjore, frikësimeve, sulmeve digjitale, fushatave shpifëse dhe formave të tjera të presionit që synojnë heshtjen e zërave kritikë. Këto situata shpesh zhvillohen me shpejtësi, duke lënë pak kohë për t'u mbështetur në procedurat standarde të financimit apo në mbështetje institucionale. Kur shfaqet një kërcënim, mundësia për të reaguar menjëherë mund të jetë vendimtare.

Fondi për përkrahje emergjente të shoqërisë civile ekziston pikërisht për t'iu përgjigjur këtyre momenteve kritike. Ai ofron mbështetje të shpejtë, fleksibile dhe proporcionale për të minuar rreziqet, për të stabilizuar situata me presion akut dhe për të mbrojtur aftësinë e akterëve të shoqërisë civile që të vazhdojnë punën e tyre në mënyrë të sigurt dhe të përgjegjshme. Përkrahje mund të kombinojë asistencë financiare me mbështetje profesionale, si ndihmë ligjore, masa që garantojnë siguri digjitale apo fizike, zhvendosje të përkohshme apo kujdes psikosocial, varësisht natyrës dhe urgjencës së situatës.

Fondi nuk ka për qëllim të zëvendësojë financimin afatgjatë apo të adresojë sfidat e qëndrueshmërisë organizative. Përkundrazi, ai është dizajnuar për të mbushur boshllëkun ndërmjet momentit kur shfaqet një kërcënim dhe momentit kur sigurohet mbështetja afatgjatë.

Fondi për përkrahje emergjente të shoqërisë civile zbatohet bashkërisht nga Fondacioni Trag dhe Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) dhe mbështetet përmes një mekanizmi të përbashkët financimi nga fondacione filantropike të përkushtuara për mbrojtjen e hapësirës qytetare në rajon.

Secili partner udhëheq vendet përkatëse për të siguruar saktësi kontekstuale dhe reagim të shpejtë:

Organizata udhëheqëse	Shtetet përkatëse
Fondacioni Trag	Serbia, Bosnja and Herzegovina, Mali i zi, Kroacia
KCSF	Kosova, Shqipëria, Maqedonia e Veriut

2. Çfarë ofron Fondi

- a. Vendimmarrje dhe grant-dhënie të shpejtë: brenda 72 orëve deri në 7 ditë
- b. Përkrahje fleksibile: nuk ka ndonjë limitim sa i përket shumës apo kohës që mund të kërkohe
- c. Përkrahje e kombinuar: grante të vogla emergjente të shoqëruara me mbështetje profesionale (ndihmë ligjore, siguri digjitale, zhvendosje, mbështetje psikosociale)

3.1 Përkufizimi i një emergjence

Fondi për përkrahje emergjente të shoqërisë civile e përkufizon emergjencën si një situatë urgjente që krijon rrezik të menjëhershëm ose të akumuluar për sigurinë apo funksionimin e akterëve të shoqërisë civile në Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë, Kroaci, Kosovë, Mal të Zi, Maqedoni të Veriut dhe Serbi.

Rrezik i akumuluar i referohet situatave ku presioni rritet me shpejtësi dhe mund të çojë në dëm serioz ose akut nëse nuk adresohet në kohë.

Këto situata mund të përfshijnë, por nuk kufizohen në:

- a. Kërcënime të drejtpërdrejta dhe intimidime
- b. Sulme ligjore ose administrative (p.sh. padi strategjike kundër pjesëmarrjes publike – SLAPP, auditime ndëshkuese)
- c. Inicim të papritur të procedurave hetimore ose presione të natyrës ligjore dhe rregullative
- d. Kërcënime ndaj sigurisë digjitale ose fizike
- e. Bastisje, arrestime ose ndalesa
- f. Sekuestrim të pajisjeve
- g. Fushata shpifëse ose sulme që për qëllim kanë dezinformimin
- h. Kufizime të së drejtës për organizim, tubim apo shprehje

Brethana të ngjajshme si ulja graduale ose tërheqja e financimit nga donatorët, vështirësi të zakonshme operacionale apo financiare, sfida afatgjata të qëndrueshmërisë, qarkullimi (ndërrimi) i stafit, nevoja për planifikim strategjik, apo vonesa në miratimin e projekteve **nuk konsiderohen emergjenca**. Po ashtu, mosmarrëveshjet e brendshme organizative, çështjet e qeverisjes së brendshme, zhvendosjet veçse të planifikuara apo kërkesat standarde rregullative të punës që nuk konsiderohen si rreziqe, bien jashtë fushëveprimtarisë së Fondit.

3.2 KUSH MUND TË APLIKOJË?

Fondi për përkrahje emergjente të shoqërisë civile është i hapur për një gamë të gjerë akterësh të shoqërisë civile që veprojnë në vendet e mbuluara nga programi. Kualifikueshmëria është e strukturuar në tri kategori:

A. Organizata të regjistruara të shoqërisë civile

Organizatat e shoqërisë civile të regjistruara ligjërisht në cilindo nga vendet e pranueshme mund të aplikojnë për mbështetje.

Kjo përfshin, por nuk kufizohet në:

- a. Organizata monitruuese dhe që promovojnë llogaridhënien (watchdogs)
- b. Iniciativa për të drejtat e njeriut, feministe, të udhëhequra nga komunitetet pakicë, mjedisore dhe iniciativa të tjera që përfaqësojnë grupe të marginalizuara
- c. Media të pavarura, jofitimprurëse

B. Grupe dhe Lëvizje Joformale

Grupet ose lëvizjet joformale, të paregjistruara, që janë aktive brenda shtrirjes gjeografike të Fondit, janë të pranueshme për përkrahje. Fondi njeh faktin se shumë iniciativa qytetare dhe forma të organizimit të shoqërisë civile funksionojnë në mënyrë joformale, veçanërisht në kontekste me presion ose rrezik të theksuar.

Si qasje e përgjithshme dhe e preferuar, mbështetja për grupet joformale ofrohet përmes një marrëveshjeje të sponsorizimit fiskal me një organizatë të regjistruar të shoqërisë civile. Në këto raste, agjenti fiskal vepron si entiteti formal dhe zbatues i grantit, duke administruar fondet në përputhje me standardet financiare dhe ligjore të Fondit, ndërsa grupi joformal zbaton aktivitetet e miratuara. Sponsorizimi përmes një agjenti fiskal inkurajohet pasi ai zakonisht mundëson zbatim më të shpejtë, llogaridhënie më të qartë dhe mbështetje më të fortë organizative për grupin, gjatë dhe pas situatës emergjente.

Aplikuesit inkurajohen, kur është e mundur, të identifikojnë vetë një agjent fiskal të përshtatshëm, si p.sh. një organizatë të besueshme të shoqërisë civile me të cilën tashmë bashkëpunojnë ose ndihen rehat të punojnë. Megjithatë, të pasurit një marrëveshje me një

agjent fiskal nuk është kusht për aplikim. Grupet joformale që nuk kanë ende një sponsor fiskal inkurajohen gjithashtu të aplikojnë. Kur një aplikim vlerësohet si relevant dhe urgjent, Fondi mund të ndihmojë aplikuesit në identifikimin e një sponsori fiskal të përshtatshëm ose të shqyrtojë forma tjera të mbështetjes

Në raste të jashtëzakonshme, kur sponsorizimi fiskal nuk mund të organizohet në kohë, në mënyrë të sigurt apo të përshtatshme për shkak të natyrës ose urgjencës së emergjencës, Fondi mund të ofrojë mbështetje përmes pagesave direkte ndaj furnitorëve ose ofruesve të shërbimeve, proces i cili kordinohet nga Fondi, me qëllim adresimin e situatës urgjente pa vonesë. Kur përdoret sponsorizimi fiskal, nënshkruhet një Marrëveshje për Sponsorizim Fiskal ndërmjet grupit joformal dhe agjentit fiskal, e cila përcakton rolet, përgjegjësitë dhe mekanizmat e llogaridhënies. Fondi do të ofrojë një shabllon të Marrëveshjes për Sponsorizim Fiskal për të mbështetur aplikuesit dhe agjentët në kordinimin e kësaj marrëveshjeje në mënyrë të shpejtë dhe të qëndrueshme.

C. Individë / Aktivistë

Individët dhe aktivistët që veprojnë brenda shtrirjes gjeografike të Fondit kualifikohen për mbështetje. Si qasje e përgjithshme, mbështetja për individët dhe aktivistët ofrohet përmes pagesave direkte ndaj furnitorëve ose ofruesve të shërbimeve të miratuara; pagesat në para të gatshme ose transferimet direkte tek aplikuesit/përfituesit individualë nuk lejohet. Kjo mund të përfshijë, për shembull, pagesa për asistencë ligjore, mbështetje për siguri digjitale ose fizike, zhvendosje të përkohshme apo kujdes psikosocial. Kjo qasje i mundëson Fondit të reagojë shpejt duke minimizuar rreziqet administrative dhe ato të sigurisë për individët.

Individët dhe aktivistët nuk janë të detyruar të kenë të identifikuar ofrues shërbimesh ose aranzhime të tjera në momentin e aplikimit. Kur një aplikim vlerësohet si relevant dhe urgjent, Fondi mund të mbështesë aplikuesit në identifikimin e ofruesve të përshtatshëm të shërbimeve dhe në koordinimin e asistencës së nevojshme.

Në disa raste, kur kjo është e përshtatshme, e sigurt dhe relevante për natyrën e mbështetjes së kërkuar, mbështetja për individët ose aktivistët mund të administrohet përmes një marrëveshjeje të sponsorizimit fiskal me një organizatë të regjistruar të shoqërisë civile që vepron si mbajtëse formale e grantit. Sponsorizimi fiskal nuk është kusht për aplikim dhe vlerësohet rast pas rasti, në varësi të kontekstit, rreziqeve dhe llojit të ndërhyrjes.

Kur përdoret sponsorizimi fiskal, lidhet një Marrëveshje për Sponsorizim Fiskal ndërmjet individit ose aktivistit dhe agjentit fiskal, e cila përcakton rolet, përgjegjësitë dhe mekanizmat e llogaridhënies. Fondi do të ofrojë një shabllon të Marrëveshjes për

Sponsorizim Fiskal për të mbështetur aplikuesit dhe agentët në kordinimin e kësaj marrëveshjeje në mënyrë të shpejtë dhe të qëndrueshme.

3.3 LLOJET E MBËSHTETJES

Nuk ka një shumë ose kohëzgjatje fikse të grantit. Komisioni Vlerësues do të shqyrtojë nëse shuma dhe kohëzgjatja e grantit të propozuar në aplikime janë proporcionale me situatën dhe nivelin e urgjencës. Madhësia dhe kohëzgjatja e çdo ndërhyrjeje do të përcaktohen në bazë të urgjencës, rreziqeve dhe kontekstit të përshkruar në aplikim, duke siguruar që mbështetja të jetë e fokusuar, proporcionale dhe i përgjigjet vetëm situatës emergjente.

Aplikuesit inkurajohen, kur është e mundur, të identifikojnë vetë një agent fiskal të përshtatshëm, si p.sh. një organizatë të besueshme të shoqërisë civile me të cilën tashmë bashkëpunojnë ose ndihen rehat të punojnë. Megjithatë, të pasurit e një agjenti fiskal nuk është kusht për aplikim. Grupet joformale që nuk kanë ende një sponsor fiskal inkurajohen gjithashtu të aplikojnë

Aplikuesit mund të propozojnë ndarjen deri në **10% të buxhetit total të grantit** për shpenzime administrative që i paguhen agjentit fiskal përgjegjës për administrimin e fondeve në emër të tyre.

Kur një aplikim vlerësohet si relevant dhe urgjent, Fondi mund të asistojë aplikuesit në identifikimin e një agjenti fiskal të përshtatshëm ose në shqyrtimin e mundësive tjera për të paguar shpenzimet. Në raste të jashtëzakonshme, kur sponsorizimi fiskal nuk mund të organizohet në kohë, në mënyrë të sigurt ose të përshtatshme për shkak të natyrës ose urgjencës së situatës, Fondi mund të ofrojë mbështetje përmes pagesave direkte ndaj furnitorëve ose ofruesve të shërbimeve, të koordinuara nga Fondi, për të siguruar që rreziqet urgjente të adresohen pa vonesë.

Kur përdoret sponsorizimi fiskal, lidhet një Marrëveshje për Sponsorizim Fiskal ndërmjet grupit joformal dhe agjentit fiskal, e cila përcakton qartë rolet, përgjegjësitë dhe mekanizmat e llogaridhënies. Fondi do të ofrojë një shabllon të Marrëveshjes për Sponsorizim Fiskal për të mbështetur aplikuesit dhe agentët në kordinimin e kësaj marrëveshjeje në mënyrë të shpejtë dhe të qëndrueshme

3.4 KUALIFIKUESHMËRIA E AKTIVITETEVE DHE SHPENZIMEVE

Çdo shpenzim që është urgjent, i domosdoshëm dhe proporcional dhe që kontribuon drejtpërdrejt në zbutjen e rrezikut ose në sigurimin e vazhdimësisë së veprimtarisë konsiderohet si shpenzim i kualifikueshëm, përfshirë, por pa u kufizuar në:

- a. Shërbime ligjore
- b. Masa sigurie

- c. Mbështetje psikologjike / psikosociale
- d. Udhëtime ose zhvendosje të përkohshme
- e. Kosto operacionale të përkohshme
- f. Masa për të mundësuar komunikim të sigurtë
- g. Mbrojtje digjitale emergjente
- h. Pagesa direkte ndaj ofruesve të shërbimeve

Kostot jo të kualifikueshme

- a. Shpenzime të pajustificuara dhe të paarsyeshme
- b. Pajisje jo-urgjente ose shpenzime për projekte afatgjata
- c. Shpenzime prej të cilave përfitojnë entitete komerciale ose politike
- d. Fonde të përkohshme (*bridging funds*) të destinuara kryesisht për të mbuluar mungesa të përgjithshme organizative ose financim bazë afatgjatë
- e. Shpenzime që nuk lidhen drejtpërdrejt me emergjencën specifike ose me ndërhyrjen e aprovuar
- f. Shpenzime që tejkalojnë qartazi çmimet standarde të tregut të cilat nuk kanë një arsyshmëri mjaftueshëm të elaboruar

3.5 PËRJASHTIME

Fondi për përkrahje emergjente të shoqërisë civile **NUK** do të mbështesë:

- a. Parti politike ose akterë që promovojnë interesa partiake
- b. Fushata lobimi ose avokime legjislative për përfitime partiake
- c. Organizata fitimprurëse
- d. Ndërhyrjet që janë në kundërshtim me vlerat themelore të Fondit, përfshirë ata që minojnë të drejtat e njeriut, parimet demokratike ose barazinë; si dhe subjekte të përfshira në aktivitete të jashtligjshme, terrorizëm ose pastrim parash
- e. Grupe që paraqesin rrezik të konsiderueshëm reputacional
- f. Propozime që bien jashtë përkufizimit të emergjencës, siç përcaktohet nga programi
- g. Subjekte që nuk dëshmojnë se veprimtaria e tyre është jofitimprurëse

4. PROCEDURA E APLIKIMIT

Aplikimet dorëzohen **ekskluzivisht përmes formularit online**, i cili është i disponueshëm në faqen e internetit të Fondit. Formulari është i dizajnuar të jetë i thjeshtë dhe lehtësisht i qasshëm për përdoruesit dhe **nuk kërkon krijimin e një llogarie** apo kalimin nëpër një

proces të veçantë regjistrimi. Ai mbledh vetëm informacionin thelbësor të nevojshëm për të vlerësuar situatën emergjente dhe për të planifikuar një reagim të përshtatshëm.

Formulari është i disponueshëm në gjuhët: **shqip, boshnjakisht, kroatisht, malazezisht, serbisht, anglisht dhe maqedonisht**. Aplikuesit mund ta plotësojnë dhe dorëzojnë formularin në cilëndo nga këto gjuhë.

Pasi aplikuesi përzgjedh vendin ku ushtron veprimtarinë e tij, aplikimi i plotësuar i përcillet automatikisht organizatës zbatuese përkatëse (Fondacionit TRAG ose KCSF) për vlerësim. Kjo siguron që çdo aplikim të shqyrtohet nga një ekip me njohuri kontekstuale për vendin përkatës, dhe në të njëjtën kohë duke siguruar një adresë të vetme aplikimi për të gjithë aplikuesit potencialë.

4.1 Informacioni i kërkuar përgjatë aplikimit

Formulari online i aplikimit do t'u kërkojë aplikuesve që të:

- Të ofrojnë informacion bazë për organizatën, grupin joformal ose individin (përfshirë statusin ligjor, nëse është i aplikueshëm), si dhe një përshkrim të shkurtër të punës/aktivizmit dhe përvojës së tyre në fushën përkatëse;
- Të përshkruajnë problemin ose kërcënimin me të cilin po përballen, duke përfshirë kontekstin, akterët përgjegjës (nëse dihen) dhe arsyen pse situata është e rëndësishme për t'u trajtuar;
- Të shpjegojnë urgjencën dhe ndikimin e pritshëm, përfshirë çfarë pritet të ndodhë në ditët ose javët në vijim nëse nuk ofrohet mbështetje;
- Të listojnë 3–5 aktivitete kyçe që propozojnë të ndërmarrin si përgjigje ndaj situatës dhe rezultatet e pritshme (p.sh. ulje e rrezikut, vazhdimësi e punës);
- Të paraqesin një përmbledhje të thjeshtë të buxhetit me linjat buxhetore dhe shumën totale të kërkuar;
- Të tregojnë nëse kanë kërkuar ose kanë marrë mbështetje të ngjashme nga burime të tjera.

Nëse keni pyetje ose paqartësi lidhur me procedurën ose aplikimin për grant, ju lutemi na kontaktoni në: **info@civicemergencyfund.com**.

Të gjitha pyetjet dhe përgjigjet lidhur me aplikimin do të publikohen në seksionin **Pyetje dhe Përgjigje (Q&A)** në faqen e internetit të Fondit. Aplikuesit këshillohen ta konsultojnë rregullisht këtë seksion përgjatë aplikimit.

Si pjesë e dorëzimit të aplikimit, çdo aplikues do t'i kërkohet të konfirmojë se:

- Informacioni i dhënë në aplikim është i vërtetë dhe i saktë sipas njohurive të tij/saj më të mira;
- Nuk është Person Politikisht i Ekspozuar (PEP) ose, kur është e aplikueshme, se asnjë PEP nuk mban pozitë drejtuese në organizatën e tij/saj;
- Pranon dhe angazhohet të respektojë vlerat themelore të Fondit, përfshirë respektimin e të drejtave të njeriut, mosdiskriminimin dhe parimet demokratike.

5. SI VLERËSOHEN APLIKIMET

5.1 Konsideratat kryesore

Aplikimet shqyrtohen duke përdorur një qasje kontekstuale dhe proporcionale, të udhëhequr nga një sërë kriteresh dhe konsideratash bazë. Pikat më poshtë shpjegojnë aspektet kryesore që përcaktojnë mënyrën se si aplikimet vlerësohen në praktikë.

Në përgjithësi, Fondi vlerëson nëse kërkesa përputhet me qëllimin dhe vlerat e tij dhe nëse lidhet me një situatë ku nevojitet përkrahje emergjente.

Merren parasysh gjithashtu urgjenca dhe serioziteti i rrezikut, si dhe nëse intervenimi i propozuar është i përshtatshme për situatën dhe ka gjasa të ndihmojë në sanimin e dëmit ose stabilizimin e situatës në një kohë të shkurtër.

Vëmendje i kushtohet besueshmërisë dhe koherencës së përgjithshme të aplikimit, duke marrë parasysh kontekstin në të cilin zhvillohet situata dhe informacionin që mund të ofrohet në mënyrë të arsyeshme në kushte emergjente.

Kur është relevante, Fondi shqyrton gjithashtu nëse veprimet e propozuara mund të zbatohen në mënyrë të sigurt dhe të përgjegjshme, si dhe nëse kohëzgjatja dhe kostoja e kërkuar janë proporcionale me emergjencën e përshkruar.

5.2 Procesi i vlerësimit

Aplikimet shqyrtohen në përputhje me konsideratat e përshkruara në Seksionin 5.1, duke ndjekur një qasje kontekstuale dhe proporcionale që pasqyron natyrën emergjente të Fondit. Procesi i shqyrtimit është i dizajnuar për të mbështetur vendimmarrje të shpejtë dhe të përgjegjshme, duke siguruar njëkohësisht trajtim të drejtë dhe të konsistent të të gjitha aplikimeve.

Çdo partner zbatues shqyrton aplikimet që dorëzohen nga vendi ose vendet nën përgjegjësinë e tij.

Si pjesë e shqyrtimit, aplikimet analizohen për të konfirmuar nëse bien brenda kritereve të Fondit dhe se lidhen me një situatë që përmbush përkufizimin e emergjencës. Aplikimet që qartazi bien jashtë mandatit të Fondit ose nuk lidhen me një emergjencë nuk procedohen më tej për vlerësim përmbajtësor.

Aplikimet që kalojnë në fazën e vlerësimit përmbajtësor shqyrtohen për të përcaktuar nëse dhe si Fondi mund të ofrojë përkrahje të përshtatshme dhe në kohë ndaj situatës së përshkruar. Kur është e nevojshme për të kuptuar më mirë kontekstin, urgjencën ose reagimin e propozuar, Fondi mund të kërkojë informacion shtesë ose sqarime nga aplikuesi gjatë procesit të shqyrtimit, duke marrë parasysh kufizimet kohore të situatave emergjente.

Paralelisht, mund të kryhen verifikime proporcionale për të siguruar që mbështetja ofrohet në mënyrë të përgjegjshme dhe në përputhje me parimet e Fondit. Këto verifikime përshtaten me llojin dhe shkallën e mbështetjes së kërkuar dhe mund të përfshijnë verifikime bazë të pranueshmërisë, statusit ligjor ose marrëveshjeve të sponsorizimit fiskal, si dhe masa tjera standarde në lidhje me integritetin e aplikantit, pa vonuar përkrahjen emergjente.

Aplikuesit njoftohen me shkrim përmes **email-it** lidhur me rezultatin e aplikimit sapo të merret vendimi.

6. RAPORTIMI

Kërkesat për raportim në kuadër të **Fondit për përkrahje emergjente të shoqërisë civile** janë të dizajnuara të jenë të thjeshta, proporcionale dhe të përshtatshme për situata emergjente.

Organizatave, grupeve joformale ose individëve të mbështetur do t'u kërkohet të paraqesin një përmbledhje të shkurtër narrative mbi mënyrën se si është përdorur përkrahja dhe rezultatet e menjëhershme të arritura, së bashku me një pasqyrë bazë financiare të shpenzimeve përkatëse.

Shkalla dhe niveli i raportimit do të varen nga lloji dhe përmasa e mbështetjes së ofruar, me synimin për të minimizuar barrën administrative, duke garantuar njëkohësisht llogaridhënie dhe përdorim të përgjegjshëm të fondeve.

VLERAT THEMELORE TË FONDIT

Ky dokument paraqet vlerat themelore që janë fundamentale për punën e të gjitha nismave të shoqërisë civile që mbështeten nga Fondi për përkrahje emergjente të shoqërisë civile. Përcakton udhëzimet e përgjithshme për llogaridhënie ndaj palëve të interesit dhe publikut për organizatat dhe aktivistët e shoqërisë civile në të gjitha nismat e mbështetura nga Fondi për përkrahje emergjente të shoqërisë civile.

Të gjithë ata që janë të përfshirë në punën e nismave të shoqërisë civile të mbështetura me grante nga Fondi për përkrahje emergjente të shoqërisë civile pritët të angazhohen dhe të veprojnë duke i respektuar këto vlera themelore në të gjitha fazat e aktiviteteve të tyre. Partnerët zbatues gjithashtu zotohen që t'i përfshijë këto vlera në të gjitha marrëdhëniet e tyre kontraktuale dhe jokontraktuale me përfituesit e granteve të tyre dhe të sigurojë që këto vlera të ruhen gjithmonë.

Transparencë dhe llogaridhënie

duke qenë të hapur, të sqartë dhe të qartë në lidhje me strukturat, misionin, politikat, aktivitetet, synimet dhe rezultatet në lidhje me Fondin, grupet e synuara dhe përfituesit dhe publikun, si dhe duke marrë përgjegjësi për veprimet e tyre dhe rezultatet e synuara dhe të pasynuara.

Integritet dhe besim

duke respektuar standardet më të larta të integritetit programor dhe financiar dhe duke shmangur keqinterpretimet, mashtrimet, keqpërdorimet e fondeve dhe/ose konfliktin e interesit, duke marrë të gjitha masat e nevojshme dhe të mundshme për të siguruar që nuk ka lidhje me persona ose organizata që dihet se janë të përfshira në praktika joetike ose të paligjshme, si dhe duke ruajtur konfidencialitetin dhe duke respektuar të drejtën për privatësi, veçanërisht kur kemi të bëjmë me informacione të ndjeshme ose private të njerëzve dhe komuniteteve.

Zotim për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, mosdiskriminim dhe drejtësi sociale

duke respektuar të drejtat e barabarta dhe dinjitetin e të gjithë njerëzve, dhe duke vlerësuar, respektuar dhe duke bërë përpjekje për ta inkurajuar diversitetin dhe mosdiskriminimin dhe trajtimin e barabartë për të gjithë, duke promovuar të drejtat e njeriut, diversitetin, barazinë gjinore, paanshmërinë, mosdiskriminimin, si në nivel të brendshëm ashtu edhe të jashtëm, si dhe duke mos u përfshirë në asnjë aktivitet, deklaratë publike dhe/ose veprime që minojnë këto vlera, si dhe duke u përpjekur për të gjetur zgjidhje të ndërgjegjshme dhe të

qëndrueshme për mjedisin dhe duke konsideruar ndikimin e mundshëm që kanë të gjitha aktivitetet e tyre në mjedis si përgjegjësi për t'u kujdesur për mjedisin dhe për ta mbrojtur mjedisin për brezat e tanishëm dhe të ardhshëm.

Demokrati dhe sundim të ligjit

duke respektuar vlerat themelore të demokracisë, duke përfshirë barazinë, respektimin e lirive themelore, qeverisjen demokratike, lirinë e mediave dhe pluralizmin, dhe pjesëmarrjen aktive qytetare, duke respektuar legjislacionin në fuqi të shtetit përkatës.

Angazhimi kundër dhunës

Duke respektuar parimet e jo – dhunës në të gjitha aktivitetet e mbështetura dhe duke mos lejuar përdorimin, promovimin apo justifikimin e dhunës ose nxitjes së dhunës. Fondi mbështet angazhimin qytetar dhe aktivizmin që zhvillohen përmes mjeteve paqësore dhe ato jo të dhunshme, përfshirë edhe në kontekste të shënuara nga tensione, represioni apo rreziqe të theksuara.

Pjesëmarrje e qytetarëve dhe angazhim i komunitetit

duke nxitur një mjedis që inkurajon pjesëmarrjen e fuqishme të çdo individ, pavarësisht prejardhjes, për t'u angazhuar në mënyrë aktive në formimin e një shoqërie të barabartë në vendet ku jetojnë, duke përfshirë komunitetet të cilave u shërbejnë në planifikimin dhe zbatimin e programeve, si dhe duke respektuar llojet e ndryshme të aktivizmit dhe pikëpamjeve për çështje me interes publik dhe duke krijuar një mjedis ku idetë mund të debatohen lirshëm.

Administrim i përgjegjshëm i burimeve dhe parimi jofitimprurës

duke u angazhuar për të menaxhuar me përgjegjësi dhe për të arritur ndikimin maksimal të burimeve financiare dhe jofinanciare të besuara, duke siguruar standarde proporcionale për procedurat financiare dhe kontrollet e brendshme, në përputhje me misionin dhe vlerat jofitimprurëse të shoqërisë civile.

Të gjithë aplikuesit janë të detyruar të deklarojnë gjatë procesit të aplikimit në sistemin online nëse respektojnë këto vlera themelore.

DEKLARATË MBI PERSONAT E EKSPOZUAR POLITIKISHT (PEP)

Person i ekspozuar politikisht do të thotë çdo person fizik, vendas ose i huaj, të cilit i është ose u janë besuar poste të larta publike, si:

- President/e, Kryeministër/e, ministër/e, zëvendësministër/e, këshilltar/e
- politik/e, shef/e i/e kabinetit
- Deputetë të Kuvendit
- Anëtarë/e të organeve drejtuese/qeverisëse të partive politike, në nivel qendror ose lokal
- Anëtarë/e të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës Supreme;
- Ambasadorë/e ose të ngarkuar me punë në përfaqësim të shtetit ose zyrtarë të lartë ushtarakë;
- Kryetarë/e komunash, nënkryetarë/e komunash, drejtorë/e komunalë,
- këshilltarë/e politikë të kryetarëve dhe nënkryetarëve shefa/e të kabinetit të kryetarëve dhe nënkryetarëve
- Anëtarë/e të listës së partive politike që garojnë në zgjedhjet lokale ose nacionale
- Anëtarë/e të kuvendeve komunale

Personat në njërin prej posteve të cekura më lart konsiderohen PEP nëse tani janë në një post të tillë ose kanë qenë në një post të tillë në një periudhë prej katër (4) vjetësh para datës së paraqitjes së kërkesës për financim në thirrjen e Fondit për përkrahje emergjente të shoqërsisë civile.

(Për OJQ-të), për të pasur të drejtë për të aplikuar për fonde në kuadër të këtij programi, personat e tillë nuk duhet të jenë në pozita udhëheqëse në organizatën jo-qeveritare që aplikon, si:

- Udhëheqës/e i/e Kuvendit të Anëtarëve,
- Udhëheqës/e ose anëtar/e i/e Bordit,
- Drejtor/e ekzekutiv/e,
- Menaxher/e (program ose financa) ose në ndonjë postë të ngjashëm të nivelit të lartë.

(Për nismat e peregjistruara si dhe individë), për të pasur të drejtë për të aplikuar për fonde të këtij program që aplikojnë duhet të sigurohen që ata, ose anëtarët e grupit, nuk bëjnë pjesë në njërin prej kategorive të shënuara më lart.

Të gjithë aplikantët kërkohet të deklarojnë gjatë aplikimit në sistemin online nëse ata bien në ndonjërin nga situatat që konsiderohen të papranueshme për shkak të përfshirjes së PEP-ëve në organizatën/nismën e tyre.